



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

VENDIM

Nr.15, datë 08.10.2024

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR NXJERRJE DHE SHFRYTËZIMI TË UJIT NËNTOKËSOR NËPËRMJET SHPIMIT PËR QËLLIME TË NDRYSHME, SUBJEKTIT "IGLI SPAHOLLI", P.F.

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "*Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre*", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje "Për nxjerrje dhe shfrytëzim të ujit nëntokësor nëpërmjet shpimit për qëllime të ndryshme", subjektit "Igli Spaholli" p.f, me vendndodhje: Fshati Buçimas, Njësia Administrative Buçimas, Bashkia Pogradec, Qarku Korçë.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e shpimit

- X = 556807

- Y = 4528670

- Z = 705 m.m.n.d

Prurja e kërkuar: $Q=0.3$ l/sek

Pika e shkarkimit

- X = 556771
- Y = 4528670
- Z = 706 m.m.n.d

Prurja që shkarkohet: $Q=0.0347$ l/sek

3. Ngarkohet Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv

KRYETARI I KBU DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

